

UDHËZIM
Nr. 585/1, datë 5.12.2013

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 15.1.2013 “MBI PROCEDURAT E
PRODHIMIT, KODIMIT, STAMPIMIT, SHPËRNDARJES DHE MONITORIMIT TË
PULLAVE TË KONTROLLIT TË BARNAVE”, I NDRYSHUAR**

Në zbatim të ligjit nr. 10 381, datë 24.2.2011 “Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave si autoritet kontraktues dhe shoqërive “Scipa Security Solutions S.A.” e “Scipa Security Solutions Albania sh.p.k.”, për projektimin, finacimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”, si dhe ligjit nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, neni 20, pika 9, ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 2, datë 15.1.2013 “Mbi procedurat e prodhimit, kodimit, stampimit, shpërndarjes dhe monitorimit të pullave të kontrollit të barnave”, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 16.1 ndryshohet si më poshtë:

16.1 Për të gjitha subjektet farmaceutike zbatimi i udhëzimit do të fillojë nga data 1 prill 2014. Pas datës 1 prill 2014, nuk do të lejohen të importohen barna, si dhe nuk do të lejohen të hidhen në treg brana të prodhuara në vend pa pullën e vetme të kontrollit të barnave të prodhuar nga koncesionari.

2. Pika 16.2 ndryshohet si më poshtë:

16.2 Pas datës 1 prill 2014, me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, inspektimet nga autoriteti përkatës në lidhje me zbatimin e këtij udhëzimi, do të kryhen në të gjithë territorin e vendit. Për shkeljen e dispozitave të këtij udhëzimi do të zbatohen sanksionet e përcaktuara në ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHËNDETËSISË
Ilir Beqaj

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani